



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Financave , Punës dhe Transfereve
Ministarstvo Financija, Rada i Transfera
Ministry of Finance, Labor and Transfers

Inspektorati i Punës / Inspektorata Rada/ Labour Inspectorate

01Nr.12-06/22

Inspektori Punës në MFPT, e Inspektoratit të Punës në Prishtinë, Ardian Megjani Nr. ID 1820, i autorizuar me dispozitën e nenit 82 dhe 94 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenin 1,2 dhe 5 të Ligjit Nr. 2002/9 dhe Ligjit Nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë,në shqyrtim të ankesës së palës ankuese Shoqata Sindikale e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës Limak Kosova "Adem Jashari", me nr.prot.14, të datës 13.01.2022, për shkak të pretendimeve për lirim nga ndërrimi i natës i punës, me datë 15.02.2022, nxjerr këtë:

VENDIM

Ankesa e palës ankuese [REDAKTUAR] me nr.prot.14, të datës 13.01.2022, ndaj punëdhënësit "Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës Limak Kosova "Adem Jashari", pas shqyrtimit, vendoset:
E Bazuar.

ARSYETIM

Pala ankuese [REDAKTUAR] në cilësinë Shoqata Sindikale e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës Limak Kosova "Adem Jashari", ka parashtruar ankesë në Inspektoratin e Punës, me nr.prot.14, të datës 13.01.2022, ndaj punëdhënësit për pretendimet për rastin e punëmarrëses [REDAKTUAR] punëmarrëse në Aeroportin Ndërkombëtar Limak Kosova "Adem Jashari", me kërkesë për t'u liruar nga ndërrimi i natës i punës për shkak të qëndrimit të gjatë në këmbë, punës së rend, etj. Pala ankuese i ka bashkangjitur ankesës dhe Raportin Mjekësor, me nr.542856. të datës 22.11.2021, Rekomanduar që pacienti duhet të lirohet nga ndërrimi i natës në vendin e punës, dhe kontroll pas tre muajsh, me nënshkrim të [REDAKTUAR] nga Spitali Amerikan, Rr.Shkupi, nr.25, Prishtinë.

Inspektori i Punës, në bazë të pretendimeve të palës ankuese, ka drejtuar kërkesë tek punëdhënësi për të kompletuar dosjet lidhur me rastin relevant. Punëdhënësi Limak Kosovo International Airport J.S.C, ka nderguar me anë të shkresës kërkesën e [REDAKTUAR] drejtuar punëdhënësit me datë 26.11.2021, përgjigjen në kërkesën e datës 21.09.2021, ku punëdhënësi e liron nga

ndërrimi i natës, dhe Raport Konsultën Mjekësore të datës 06.09.2021, ku punëmarrësia me rekomandim mjekësor rekomandohet për lirimin nga puna e ndërrimit të natës.

IP, konstaton se Bazuar në Raportin Mjekësor të datës 22.11.2021, me nr.542856, të datës 22.11.2021, Rekomanduar që pacienti duhet të lirohet nga ndërrimi i natës në vendin e punës, dhe kontroll pas tre muajsh, me nënshkrim të [REDACTED] nga Spitali Amerikan, Rr.Shkupi, nr.25, Prishtinë.

Rjedhimisht, IP, konstaton se ankesa e palës ankuese është e bazuar, dhe punëdhënësi Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, të veproj, në përputhje me Ligjin Nr.03/L-212 të Punës, Neni 27, paragrafi 4, 'Ne qoftë se të punësuarit gjatë punës së natës, për shkak të punës së bërë sipas vlerësimit të organit kompetent shëndetësor, i përkeqësohet gjendja shëndetësore, punëdhënësi është i detyruar ta caktojë në punë të përshtatshme gjatë orarit të ditës'.

Inspektorati i Punës, paraprakisht ka nxjerrur dhe dorëzuar Raportin Zyrtar RZ01Nr.12-06/22, lidhur me ankesën e palës ankuese.

Andaj, në bazë të rrethanave të theksuara më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim është përpiluar në kopje të mjaftueshme identike nga 1 kopje i dorëzohet palëve në procedurë, ndërsa kopjet tjera Inspektori i punës i mbanë për procedurë të më tutjeshme.

Inspektori i Punës
Ardian Megjani ID- 1820



Udhëzim juridik: kundër këtij Vendimi lejohet ankesë në afatë prej 8 ditësh tek organi i shkallës së dytë të Inspektoratit të punës, nëpërmes Inspektoratit të Punës së shkallës së parë në adresë :Rr. Fehmi Agani, Nr.72,Prishtinë,10000.